



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
30-03-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština
Nr./Br. 278-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 59.3 paragrafi (b) të 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen datës 30.03.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Projekti për “Ridizajnimin e ueb faqes të KQZ-së”.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi, është Projekti si në pikën I të këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.03.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka





Projekti - Ridizajnimi i ueb faqes së KQZ-së

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT	
Titulli i projektit:	Ridizajnimi i ueb faqes së KQZ-së
Qëllimi përgjithshëm:	Përmes këtij projekti synohet që KQZ-ja të ketë paraqitje sa më të denjë në publik, si dhe të ofroj informacione lehte të qasshme dhe shërbime tjera për votuesit, në llogari të rritjes së transparencës së KQZ-së. Po ashtu, synohet që ueb faqja të modernizohet që jetë e lehte në përdorim, në hap me ndryshimet teknologjike dhe plotësimin e kërkesave për të Dhëna te Hapura (Open Data).
Periudha implementimit:	Shkurt – Shtator 2017
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë
Përfituesit:	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Udhëheqës të Projektit	DTI

Përmbajtja

1	Hyrje.....	3
1.1	Qëllimi	3
1.2	Aktivitetet.....	3
1.3	Rezultatet e pritura	4
1.4	Kostoja financiare e paralogaritur.....	4
2	Specifikat teknike për dizajnimin dhe zhvillimin e uebfaqes	5
2.1	Kërkesat për Operatoret Ekonomik	7

1 Hyrje

Në këtë dokument është paraqitur nevoja që ueb faqja aktuale e KQZ-së të ridizajnohet, thjeshtëzohet dhe të zgjerohen funksionet aktuale të saj.

Duke pasur parasysh që KQZ-ja përgjatë katër viteve, prej kur është lansuar ueb faqja aktuale ka avancuar me shërbimet që ofron për votuesit, është shfaqur nevoja që të njëjtat të vihen në dispozicion për publikun. Prandaj, ridizajnimi i ueb faqes do të akomodonte platformat e reja të cilat KQZ-ja ka zhvilluar dhe do të përmirësonte eksperiencën e përdoruesit gjatë shfletimit të saj.

Gjithashtu, ridizajnimi i ueb faqes shfaqet si nevojë si për ta bërë më lehtë të përdorshme nga përdoruesit e jashtëm ashtu edhe si nevojë karshi ndryshimeve teknologjike të cilat janë mjaft dinamike në këtë fushë. Teknologjia që përdoret për zhvillimin e ueb faqeve ka ndryshuar shumë shpejtë gjatë kësaj kohe, prandaj edhe KQZ-ja do të jetë në hap me këto ndryshime. Prej kohës kur është zhvilluar ueb faqja e KQZ-së, mënyra se si përdoruesit bashkëveprojnë me ueb faqen ka pësuar ndryshime të shumta. Prandaj, këtë mënyrë të re të punës do ta kenë edhe përdoruesit që vizitojnë ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

1.1 Qëllimi

Përmes këtij projekti synohet që KQZ-ja të ketë paraqitje sa më të denjë në publik, si dhe të ofroj informacione më të qasshme dhe shërbime tjera për votuesit, gjë që rrit transparencën e KQZ-së. Po ashtu, synohet që ueb faqja të jetë në hap me ndryshimet teknologjike që ndodhin në këtë fushë.

1.2 Aktivitetet

1. Vlerësimi i nevojave
2. Hartimi i termave të referencës
 - a. Konsultimet e brendshme
 - b. Konsultimet e jashtme
3. Shqyrtimi dhe aprovimi
 - a. Shqyrtimi dhe aprovimi në KOZ
 - b. Shqyrtimi dhe aprovimi në KQZ
4. Tenderimi
5. Zhvillimi dhe instalimi

1.3 Rezultatet e pritura

Pas implementimit të këtij projekti, përkatësisht ridizajnit të ueb faqes së KQZ-së, KQZ do të ketë një ueb faqe më profesionale, më informative si dhe një lehtësi më të madhe për publikun që të qaset në shërbimet që ofrohen nga KQZ-ja

1.4 Kostoja financiare e paralogaritur

Kostoja e paralogaritur për ridizajni e ueb faqes së KQZ-së është 7,000.00 €. Kostoja është llogaritur në bazë të referencave të mëhershme të zhvillimit të ueb faqes si dhe bazuar në çmimin e tregut.

2 Specifikat teknike për dizajnimin dhe zhvillimin e uebfaqes

Më poshtë janë listuar kërkesat minimale që KQZ pretendon të jenë komponentet, funksionet apo veçoritë që ueb faqja e KQZ-së duhet të ketë. Funksionet duhet të kenë mundësinë e aktivizimit dhe deaktivizimit, varësisht prej nevojave të KQZ-së.

I. Dizajni

1. Të ketë dizajn të bazuar në ngjyrat e logos zyrtare.
2. Të ketë navigim të zgjerueshme dhe statik në çdo faqe.
3. ~~Ueb faqja duhet~~ Të jetë responsive dhe mobile friendly. Të jetë e arritshme nga pajisjet mobile, tabletat, dhe teknologjive të tjera në zhvillim. Ueb faqja duhet t'i përshtatet ekranit të pajisjes së përdoruesit në mënyrë automatike.
4. Dizajni dhe organizimi i ueb faqes duhet të jetë kombinim i akordioneve dhe blloqeve ilustrative.

Standardet e përdorshmërisë (usability)

5. Të mos listohen më shumë se 7 seksione në një grup të navigimit. ~~meqë kjo e ngarkon memorien e shfrytëzuesit.~~
6. Të shmangen hierarkitë e informatave që shkojnë më shumë se tri nivele në thellësi, meqë kjo do të nënkuptonte që informatat do të jenë më larg se tre klika larg.
7. Të shmangët përdorimi i faqeve vetëm për hir të dizajnit (si shembull splash screen për zgjedhje të gjuhës) duke dalë drejtpërsëdrejt në përmbajtje me paraqitje të dukshme të mundësisë së ndërrimit të gjuhës.
8. Të mbahen tekste të shkurta dhe të ngushta (sa shtyllat e gazetave) në mënyrë që leximi të mos bëhet i mundimshëm.

Standardet e qasshmërisë (Accessibility)

9. Të siguroj që qasja në ueb faqe të jetë e mundshme për platforma të ndryshme dhe për njerëz me aftësi të kufizuara.
10. Të ketë kontrast të mjaftueshëm mes sfondit dhe tekstit si dhe ngjyra komplementare.
11. Madhësia e germave të jetë e rritshme / zvoglueshme.
12. Fotografitë të kenë legjendë tekstuale.

Standardet teknike

13. Ueb faqja duhet të kaloj validimin në W3C, shërbim që verifikon nëse dokumentet e gjeneruara HTML dhe XHTML janë konform me rekomandimet e standardit W3C. Validimi duhet të bëhet në:
 - i. XHTML coding (<http://validator.w3.org/>)
 - ii. CSS coding (<http://jigsaw.w3.org/css-validator/>)
 - iii. Dobia nga validimi me këto standarde qëndron në:
 1. Përmirësimin e kohëzgjatjes së gjenerimit të faqes
 2. Përmirësimin e funksionalitetit në browser të ndryshëm
 3. Përmirësimin e pozicionimit në makina kërkuese, ~~sidomos google vlerëson më lartë faqet me kod standard~~

II. Funkzioni

14. Të ketë motor për kërkim për të gjitha materialet e publikuara në ueb.
15. Të jetë në të tri gjuhët (Shqip, Anglisht dhe Serbisht) me mundësi shtimi.
16. Të ketë një kalendar ku mund të regjistrohen të gjitha festat, ngjarjet dhe lajmet zyrtare.
17. Të ketë rubrikën ku shfaqen azhurnimet e fundit që kanë ndodhe në ueb faqe.
18. Të ketë mundësi për zgjerim (scalability).
19. Të ketë pjesën e menaxhimit të freskimeve bazuar në strukturën e punës dhe të punoj në konceptin që njeri shfrytëzues të jetë "Data Entry" dhe tjetri "Data Authorizer".
20. Të ketë lidhjen për e-mail zyrtar.
21. Të ketë hartën e ueb faqes, adresar dhe grupim të institucioneve të licencuara, si dhe listë të anëtarëve të KQZ - së me biografi dhe fotografi.
22. Të hapet shpejt edhe në momentet e frekuentimit të një numri të madh vizitorësh dhe të eliminohet koha e mos qasjes.
23. Të ketë ndërlidhje automatike me rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram dhe Youtube.
24. Të ketë linqe ndërlidhëse me institucionet dhe organizatat tjera.
25. Të ketë funksion për njoftim automatik për takimet që do të mbahen përmes funksionit për regjistrimit për pranimin e newsletter apo publikime të tjera duke :
 - i. Publikuar në kalendar njoftimin
 - ii. Dërguar email për pjesën e mediave, OJQ dhe pjesëmarrësit tjerë.
26. Të ketë më shumë se një funksion për ndërlidhje me ueb aplikacionet tjera që KQZ ka dispozicion.
27. Të ketë funksion interaktiv i cili do t'i shfaqte lajmet e fundit të KQZ-së (slider) dhe do të duhet të jetë i dallueshëm në ballinën e uebfaqes.
28. Të ketë funksion në ueb faqe i cili paraqet në ballinë mbledhjet e fundit të KQZ-së dhe agjendën (rendin e ditës).
29. Të zhvillohet një modul për futjen e formularëve të publikimit financiar të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre (diku rreth 6000 mijë kandidatëve).
30. Të zhvillohet sistemi për menaxhimin e përmbajtjes (CMS) me nivele të ndryshme të qasjes, bazuar në privilegje të caktuara për përdorues.
31. Të ketë autentifikimin për përdorues.
32. Të ju mundësoj përdoruesve të shpëndajnë informatat e prezantuara në ueb faqe në rrjete sociale.
33. Të ketë mundësi për ngarkimin dhe prezantimin e videove dhe të fotografive të ngjarjeve. Këtu përfshihet edhe mundësia e transmetimit të drejtëpërdrejtë të mbledhjeve të KQZ-së si dhe uploadimi dhe prezantimi i videove të mbledhjeve paraprake.
34. Të ketë bazë të të dhënave në SQL Server.
35. Të instalohet dhe funksionalizohet në uebserverin e KQZ-së.
36. Të bëjë migrimin e të dhënave aktuale që KQZ ka në dispozicion.
37. Të ketë funksionin e evidentimit të ngarkimeve dhe publikimit të materialeve në CMS. Në këtë funksion përveç paraqitjes në ueb duhet të mund të ekstrahet raporti i cili përmban titullin e publikimit, seksionin (apo pjesën) ku është publikuar, datën e publikimit, dhe gjuhën.
38. Të ketë mundësinë e shkarkimit të të gjitha materialeve të prezantuara në një seksion të caktuar (si shembull shkarkimi i të gjitha rregullave të zgjedhjeve ose vendimeve të marra brenda një periudhe të caktuar).
39. Të ketë mundësi për të paraqitur pop-ups me dizajn të paracaktuar, në të gjitha komponentet e ueb faqes.

40. Të ketë segmente interaktive të cilat mund të vendosen në të gjitha komponentet e ueb faqes.

Nr.	Emërtimi	Sasia (copë)	Çmimi për copë me TVSH	Totali me të gjitha taksat
1.	Zhvillimi i ueb faqes së KQZ-së	1		
2	Mirëmbajtja dhe përkrahja teknike	1 vit		

2.1 Kërkesat për Operatoret Ekonomik

Propozimin teknik - që përfshinë paku dy (2) propozime të dizajnit dhe strukturës së ueb faqes të paraqitura me ngjyra. Propozimet duhet të përmbajnë kërkesat e listuar me lartë dhe shërbejnë si orientim për vlerësimin e ofertave të dorëzuara.

- a) Për ballinën
 - Qe përmban seksionet
 - Pjesën kryesore - që prezanton azhurnimet në secilin material të publikuar apo ndryshuar.
 - Navigimin anësor
 - Ndërlidhja me modulet e jashtme (Shembull: dmp.kqz-ks.org)
- b) Seksionin Rreth KQZ-së
 - Prezantimin tekstual
 - Nenseksionet
 - Paraqitjen e biografive të anëtareve të KQZ
- c) Formën e kontaktit
 - Paraqitjen interaktive te hartës
 - Formën për kontakt dhe qasje në dokumente
- d) Kalendarin e takimeve
 - Listimin e takimeve
 - Paraqitjen e datave në kalendar (markimin kur ka ngjarje)

Planin kohor të implementimit – që përfshinë aktivitetet dhe afatet kohore në fazat e punës si vijon

- a) Sitemap
- b) Wireframe
- c) Dizajni
- d) Implementimi
- e) Trajnimi
- f) Instalimi dhe testimi
- g) Mirëmbajtja

Portfolio - që përfshinë se paku pesë (5) referenca për zhvillimin e ueb faqeve apo ueb aplikacioneve të shoqëruar me foto me ngjyra dhe linqet ku janë të vendosura.

Përkrahja - Operatoret Ekonomik duhet të ofrojnë përkrahje teknike për periudhë 1 vjeçare nga data e instalimit të versionit përfundimtar.